



# **PROGRAMI I ZHVILLIMIT RAJONAL SHQIPËRI** **DRAFT KONTRATË GRANTI TIP**

## Tabela e Përmbajtjes

NENI 1 .....	3
Përkufizime .....	3
NENI 2 .....	4
Qëllimi i Kontratës.....	4
NENI 3 .....	4
Financimi i Projektit.....	4
NENI 4 .....	4
Periudha e zbatimit të Projektit .....	4
NENI 5 .....	4
Detyrime të Përgjithshme të Palëve .....	4
NENI 7 .....	6
Kosto të lejueshme.....	6
NENI 8 .....	7
Planifikimi dhe Procedura e Pagesës .....	7
NENI 9 .....	8
Llogaritë dhe kontrollet teknike dhe financiare .....	8
NENI 10 .....	10
Shuma përfundimtare e Grantit .....	10
NENI 11 .....	10
Rikuperimi.....	10
NENI 12 .....	10
Detyrimi për të paraqitur Raporte Narrative dhe Financiare .....	10
NENI 13 .....	11
Vlerësimi/Monitorimi i Projektit.....	11
NENI 14 .....	11
Modifikime të Kontratës .....	11
NENI 15 .....	12
Zbatimi.....	12
NENI 16 .....	12
Shtyrja e periudhës së zbatimit të projektit.....	12
NENI 17 .....	12
Pezullimi.....	12
NENI 18 .....	13
Ndërprerja e Kontratës .....	13
NENI 19 .....	14
Sanksione administrative .....	14
NENI 20 .....	15
Dispozita përfundimtare .....	15
20.1. Përgjegjësia .....	15
20.2. Konflikti i interesit dhe sjellja e mirë .....	15
20.3. Konfidencialiteti.....	15
20.4. Pronësia/Përdorimi i rezultateve dhe asetëve .....	15
20.5. Mbrojtja e të dhënave .....	16
20.6. Vizibiliteti dhe Komunikimi Publik .....	16
20.7. Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve .....	16
20.8. Heqja dorë.....	16
20.9. Pasardhësit dhe nënkontraktimi .....	16
20.10. Vlefshmëria .....	17
20.11. Kopjet.....	17
20.12. Procedura e njoftimit .....	17
20.15. Anekse.....	17



**KONTRATË GRANTI**  
**PROGRAMI I ZHVILLIMIT RAJONAL NË SHQIPËRI**  
Numër identifikimi i kontratës së grantit ...('Kontrata')

Fondacioni “Programi i Zhvillimit Rajonal Shqipëri”, Autoriteti kontraktues për Programin e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (PZHRSH) – Skema e Granteve të PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, me zyra të regjistruara në adresën Rr. Mustafa Matohiti, Nr.4, Tirana, Shqipëri, me NIPT L72118453G, përfaqësuar nga Z. Denis Van Dam,

dhe

\_\_\_\_\_ (emri i plotë) \_\_\_\_\_ (statusi juridik i organizatës) \_\_\_\_\_ (numri i regjistrimit),  
\_\_\_\_\_ (emri dhe të dhënat të ID-së së përfaqësuesit) \_\_\_\_\_ (adresa)  
\_\_\_\_\_ (numri NIPT për përfituesit e regjistruar) në cilësinë e Përfituesit të Skemës së Granteve të PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin,

*Autoriteti kontraktues dhe Përfituesi në këtë Kontratë referohen veçmas si Palë dhe bashkërisht si Palët.*

**DUKE PASUR PARASYSH QË:**

- A) Republika e Shqipërisë dhe Qeveria Zviceriane kanë nënshkruar në 11 Maj 2017 një Marrëveshje Kuadër për Ndhimën Humanitare Teknike dhe Financiare për Bashkëpunim;
- B) Republika e Shqipërisë dhe Qeveria Zviceriane kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për Programin e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri të ratifikuar me ligjin shqiptar nr. 99/2020 që përcakton asistencën dhe financim për realizimin e Projektit- Programi i Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë, Faza IV.
- C) ECORYS NL ka ngarkuar Fondacionin “Programi i Zhvillimit Rajonal Shqipëri” me ekzekutimin e PZHRSH në Shqipëri .
- D) Autoriteti kontraktues nga ana e tij ka caktuar funksionet e Entit të Deleguar Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
- E) Palët dëshirojnë të lidhin këtë Kontratë Granti sipas kushteve dhe afateve të parashikuara më poshtë.

**NENI 1**  
**Përkufizime**

Sa më poshtë do të përdoret për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

- “**Projekt**” do të thotë projekt i përzgjedhur në kuadër të Skemës së Granteve të PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin;
- “**Ditë**” do të thotë ditë kalendarike;
- “**Forca madhore**” për qëllim të kësaj Kontrate Granti mbulon çdo ngjarje të paparashikueshme, jashtë kontrollit të një Pale të kësaj Kontrate dhe që me ushtrimin e kujdesit të duhur të secilës Palë të kësaj Kontrate asnjë Palë nuk mund ta kapërcejë, të tillë si veprat e Zotit, grevat, pezullimet ose aksione të tjera industriale, aktet e kërcënimit publik, luftëra të shpallura ose jo, bllokadat, rebelimin, kryengritjen, epideminë, rrëshqitjet e tokës, tërmetin, stuhinë, rrufetë, përmbytjet, erozionet, trazirat civile, shpërthimet.
- “**Përfituesi**” do të thotë një organ publik përgjegjës për fillimin dhe zbatimin e një Projekti;
- “**Thirrje për Aplikime**” do të thotë ftesa publike nga Autoriteti kontraktues, dhe çdo korigjim i Thirrjes për Aplikime, drejtuar një kategorie të identifikuar qartë të aplikantëve, për të propozuar Projekte brenda kuadrit të **Skemës së Granteve të PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin**, që përmban afatet dhe kushtet e pjesëmarrjes.
- “**Faza IV e Programit të Zhvillimit Rajonal të Shqipërisë (PZHRSH)**” është Programi i miratuar sipas ligjit nr.99/2020 që përfaqëson angazhimin formal të Qeverisë Zviceriane (Donator) për financimin e Projekteve në kuadër të Programit.
- “**Autoriteti kontraktues**” është subjekti përgjegjës për menaxhimin dhe zbatimin e **Skemës së Granteve të PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin**;
- “**Enti i deleguar**” është subjekti të cilit Autoriteti Kontraktues i delegon funksione në mbështetje të menaxhimit dhe zbatimit të **Skemës së Granteve të PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin**.

- “Detyrime thelbësore” për qëllim të kësaj Kontrate do të thotë detyrime të përcaktuara në nenin 9.9 më poshtë.

## NENI 2

### Qëllimi i Kontratës

- 2.1. Qëllimi i kësaj Kontrate është që të miratojë grantin e Autoritetit Kontraktues për financimin dhe zbatimin e projektit me titull: \_\_\_\_\_ (tani e më tutje “Projekti”), siç përshkruhet në Aneksin II “Përshkrimi i Projektit (Aplikimi)”, bashkëlidhur kësaj Kontrate.
- 2.2. Përfituesi fiton grantin sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë dhe anekset bashkëlidhur që janë pjesë e pandarë e saj, të cilat Përfituesi me anë të kësaj deklaron që ka shqyrtuar dhe pranuar.
- 2.3. Përfituesi pranon grantin dhe merr përsipër të jetë përgjegjës për realizimin e Projektit.

## NENI 3

### Financimi i Projektit

- 3.1. Autoriteti Kontraktues merr përsipër të financojë 100 % të kostos totale të lejueshme të Projektit, me shumën maksimale prej \_\_\_\_\_ LEKË.
- 3.2. Përfituesi do të financojë shumën prej \_\_\_\_\_ LEKË, që përkon edhe shumën totale të TVSH-së së kostove për aktivitetet e planifikuara për tu zbatuar gjatë projektit.
- 3.3. Kostot totale të lejueshme, sic përcaktohet në pikat 3.1 dhe 3.2 të këtij neni vlerësohen në LEKË, siç parashikohet në Aneksin III “Buxheti i Projektit” bashkëlidhur kësaj Kontrate, ku janë lehtësisht të identifikueshme se cilat financohen nga Autoriteti Kontraktues dhe cilat bashkë-financohen nga Përfituesi.
- 3.4. Në rast se Përfituesi dështon në të gjitha fazat e zbatimit të projektit, për të përmbushur plotësisht ose pjesërisht detyrimin që rrjedh nga pika 3.2, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën e tij për të ndërprerë këtë Kontratë në përputhje me nenin 18 të kësaj Kontrate.

## NENI 4

### Periudha e zbatimit të Projektit

- 4.1. Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Pala e dytë.
- 4.2. Zbatimi i Projektit fillon ditën e parë pas hyrjes në fuqi të Kontratës.
- 4.3. Periudha e zbatimit të Projektit, e përcaktuar në Aneksin II, është \_\_\_\_\_.
- 4.4. Periudha e ekzekutimit të kësaj Kontrate mbaron kur Autoriteti Kontraktues bën pagesën e diferencës ose kur Autoriteti kontraktues rimerr çdo shumë që i është paguar Përfituesit në mënyrë të parregullt në përputhje me nenin 11 dhe, në çdo rast, maksimumi 6 muaj pas mbarimit të periudhës së zbatimit të përcaktuar në nenin 4.3 përveçse nëse shtyhet në përputhje me nenin 18.6 të kësaj Kontratës.

## NENI 5

### Detyrime të Përgjithshme të Palëve

#### 5.1. Detyrime të Përfituesit

Gjatë periudhës së zbatimit të kësaj Kontrate, Përfituesi:

- a. realizon projektin, merr të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme për t’u siguruar që Projekti të zbatohet në përputhje me Përshkrimin e Projektit në Aneksin II afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate dhe Aneksit e saj. Për këtë qëllim, Përfituesi zbaton Projektin me kujdesin e kërkuar, efikasitet, transparencë, mirëbesim dhe kujdes, në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe me praktikën më të mirë në fushë;
- b. është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që i vendosen nga kjo Kontratë;
- c. i dërgon Autoritetit Kontraktues, Entit të Deleguar ose çdo organi tjetër të caktuar nga Autoriteti Kontraktues të dhënat e nevojshme për të hartuar raporte, deklarata financiare dhe informacion ose dokumente të tjera të kërkuara nga kjo Kontratë dhe Aneksit e saj, si edhe çdo informacion të nevojshëm në rast të verifikimeve, kontrolleve, monitorimit ose vlerësimeve, të përshkruar në nenin 9 të kësaj Kontrate;
- d. sigurohet që i gjithë informacioni që i jepet dhe kërkesat që i bëhen Autoritetit Kontraktues t’i dërgohen përmes Entit të Deleguar;

- e. bie dakord për rregullimet e duhura për koordinim të brendshëm dhe përfaqësim të Përfituesit *vis-a-vis* Autoritetit Kontraktues për çdo çështje në lidhje me këtë Kontratë, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe në përputhje me legjislacionin e shqiptar përkatës;
- f. ka përgjegjësi të plotë financiare për të siguruar zbatimin e Projektit në përputhje me këtë Kontratë;
- g. përcakton kërkesat për pagesë në përputhje me Kontratën;
- h. është marrësi i vetëm i pagesave të Autoritetit Kontraktues.
- i. Garanton që Partneri(et) përfitues zbaton detyrimet e tij sipas kontratës së grantit, sic është parashikuar në aplikim;
- j. Garanton që të gjitha shpenzimet e kryera janë në përputhje me rregullat e parashikuara të ligjit për prokurimin publik, dhe nëse përjashtime për alokim fondesh aplikohen sikurse janë parashikuar në Thirrjen për Aplikime ato janë të mirë-justifikuara sipas kriterëve të përcaktuara.
- k. Konfirmon lejueshmërinë e shpenzimeve, përfshirë kostot e faturuara nga partneri(et) e asociuar.

## 5.2. Detyrime të Autoritetit Kontraktues

Gjatë periudhës së zbatimit të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues:

- a. i komunikon Përfituesit, përmes nëpunësit të tij të autorizuar ose Entit të Deleguar në lidhje me çdo çështje që mund të paraqitet gjatë zbatimit të Kontratës;
- b. bën pagesat sipas dispozitave të nenit 8 të kësaj Kontrate;
- c. njofton Përfituesin në lidhje me çdo delegim të funksioneve të tij tek Enti i Deleguar ose organe të tjera, sipas nevojës;
- d. është përgjegjës për përmbushjen në mirëbesim të detyrimeve që i vendosen nga kjo Kontratë.

## NENI 6

### Delegimi i funksioneve të Autoritetit Kontraktues

- 6.1. Autoriteti Kontraktues i delegon Entit të Deleguar funksionet e mëposhtme:
  - a. të monitorojë zbatimin e Projektit në përputhje me këtë Kontratë dhe të sigurojë koordinimin me Përfituesin në zbatimin e Projektit;
  - b. të ndërmjetësojë të gjithë komunikimet ndërmjet Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktues;
  - c. të jetë përgjegjës për verifikimin e saktësisë dhe dhënien e të gjithë dokumentacionit dhe informacionit tek Autoriteti Kontraktues që mund të kërkohet sipas kësaj Kontrate, sidomos në lidhje me raportet narrative dhe financiare dhe kërkesat për pagesë. Nëse kërkohet informacion nga Përfituesi, Enti i Deleguar është përgjegjës për të marrë, verifikuar dhe konsoliduar informacionin përpara se t'ia përcjellë Autoritetit Kontraktues. Çdo informacion i dhënë, si edhe çdo kërkesë e bërë nga Enti i Deleguar tek Autoriteti Kontraktues, do të konsiderohet i dhënë në marrëveshje me Përfituesin;
  - d. të mbështetë Autoritetin Kontraktues për rikuperimet që duhet t'i merren Përfituesit në përputhje me nenin 11 të kësaj kontrate;
  - e. të informojë Autoritetin Kontraktues për çdo rast që mund të ndikojë ose vonojë zbatimin e Projektit;
  - f. të informojë Autoritetin Kontraktues për çdo ndryshim në situatën ligjore, financiare, teknike, organizative ose pronësore të Përfituesit, si edhe çdo ndryshim të emrit, adresës ose përfaqësuesit ligjor të Përfituesit;
  - g. të jetë i pranishëm dhe të ofrojë mbështetje në rastin e kontrolleve, auditit, monitorimit ose vlerësimeve, të përshkruara në nenin 9 të kësaj Kontrate, për të dhënë të gjithë dokumentet e nevojshme, përfshirë llogaritë e Përfituesit, kopje të dokumentacionit më të rëndësishëm mbështetës dhe kopje të firmosura të çdo kontrate të lidhur sipas nenit 15 të kësaj Kontrate;
  - h. të ushtrojë të gjitha funksionet e tjera të përcaktuara në këtë Kontratë;
  - i. të mos delegojë ndonjë, ose një pjesë të, këtyre detyrave tek Përfituesi ose subjekte të tjera.
- 6.2. Enti i Deleguar ka të njëjtin autoritet si Autoriteti Kontraktues ndaj Përfituesit në lidhje me funksionet e deleguara sipas nenit 6.1 më sipër dhe Përfituesi e trajton Entin e Deleguar si duhet, duke i dhënë aksesin e nevojshëm në përputhje me nenin 9 më poshtë dhe plotësisht në përputhje me kërkesat e tij.
- 6.3. Autoriteti Kontraktues mund të delegojë funksione dhe detyra shtesë sipas kësaj Kontrate tek Enti i Deleguar. Ai e njofton Përfituesin me shkrim këtë rast brenda 10 (dhjetë) ditëve të këtij vendimi sipas procedurës së njoftimit të përcaktuar në nenin 20.12 më poshtë. Njoftimi me shkrim rendit funksionet që i delegohen Entit të Deleguar.

## NENI 7 Kosto të lejueshme

### 7.1. Krite për lejueshmërinë e kostove

Kostot e pranueshme janë kostot e bëra nga Përfituesi që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. ato janë bërë gjatë zbatimit të Projektit siç specifikohet në Nenin 4 të kësaj Kontrate.
- b. tregohen në Buxhetin e përgjithshëm të përlogaritur për Projektin siç parashikohet në Aneksin III të kësaj kontrate;
- c. janë të nevojshme për zbatimin e Projektit;
- d. janë të identifikueshme dhe të verifikueshme sidomos të regjistruara në regjistrin e llogarive të Përfituesit dhe të përcaktuara sipas standardeve të mbajtjes së llogarive dhe praktikave të zakonshme të llogaritjes së kostos që zbatohen për Përfituesin;
- e. përputhen me kërkesat e legjislacionit shqiptar;
- f. në rastet e kostove brenda kufirit prej 20% të buxhetit total, të faturuar nga partneri i asociuar në projekt në bazë të kontratës së dhënë në mënyrë të drejtpërdrejt nga bashkia përfituese, të tilla kosto justifikohen vetëm nëse partneri provon (format elektronik apo fizik) ekspertizën e kërkuar me të paktën dy aktivitete apo shërbime të ngjashme me aktivitetet e projektit.
- g. janë të arsyeshme, të justifikuar dhe përputhen me kërkesat e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, sidomos në lidhje me ekonominë dhe eficientësinë.

Kostot në lidhje me shërbimet dhe punimet duhet të jenë në linjë me aktivitetet e kryera gjatë periudhës së zbatimit.

Kostot në lidhje me furnizimet lidhen me dorëzimin dhe instalimin e sendeve gjatë periudhës së zbatimit. Nënshkrimi i një kontrate, bërja e një porosie, ose marrja përsipër e një angazhimi për shpenzime brenda periudhës së zbatimit për ofrimin e ardhshëm të shërbimeve, si dhe kryerja e punimeve ose furnizimeve pas mbarimit të periudhës së zbatimit, nuk do konsiderohen në përputhje me këtë përcaktim.

Kostot e kryera duhet të paguhen përpara paraqitjes së raportit përfundimtar. Ato mund të paguhen më pas nëse renditen në raportin përfundimtar së bashku me datën e përlogaritur të pagesës që do të jetë jo më vonë se data përmblyëse e zbatimit të projektit.

### 7.2. Kosto të lejueshme

Sa më poshtë do të konsiderohen kosto të lejueshme sipas kësaj Kontrate:

- a. Punimet për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e infrastrukturës fizike që është në pronësi të përfituesit ose mirëmbajtja e të cilës është përgjegjësi e përfituesit;
- b. Blerja e pajisjeve, mobiljeve dhe furnizimeve që janë ndihmëse për punimet e lartpërmendura;
- c. Furnizimi me pajisje teknike dhe infrastrukturë IT;
- d. Shërbime konsulence;
- e. Kostot për vizibilitetin dhe eventet e vizibilitetit për aktivitetet e financuara;
- f. Kostot për organizimin e eventeve, trajnimeve, përfshirë qiranë e ambienteve dhe pajisjeve, materiale mësimi dhe trajnimesh, pushime për kafe, etj.
- g. Shërbimet për mbikqyrjen e punimeve;
- h. Tarifat bankare.

Kostot e tilla janë të lejueshme nëse janë kryer dhe faturuar brenda periudhës së zbatimit të kontratës së grantit.

Me qëllim që shpenzimet të jenë të pranueshme, Përfituesi i jep Autoritetit Kontraktues, nëpërmjet Entit të Deleguar, bashkëlidhur raporteve financiare të kërkuara sipas nenit 12, edhe një kopje të çdo fature që është njehsuar me origjinalin nga Bashkia dhe me vulën e bashkisë.

### 7.3. Kosto që nuk lejohen

Kostot e mëposhtme nuk konsiderohen të pranueshme:

- a. Pagat dhe kosto të tjera operacionale të Bashkive apo Partnerëve të Bashkive përfituese;
- b. Kontributet në natyrë;
- c. Shpenzime të kryera përpara firmosjes të kontratës së grantit;
- d. Kosto për përgatitjen e Projektit;
- e. Borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);
- f. Dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- g. Kosto të deklaruara nga përfituesi dhe të financuara nga një tjetër Projekt nën një tjetër burim financimi;
- h. Blerje e tokës ose ndërtesave;
- i. Qera nga asetet;
- j. Kredi ndaj palëve të treta;
- k. TVSH-ja;
- l. kostot që nuk janë listuar në pikën 7.2.

## NENI 8

### Planifikimi dhe Procedura e Pagesës

#### 8.1. Planifikimi i Pagesës

Autoriteti Kontraktues duhet t'i paguajë Përfituesit grantin sipas planifikimit të mëposhtëm të pagesës:

- a. një pagesë fillestare parafinancimi prej 80% të shumës maksimale të përmendur në nenin 3.1 të kësaj Kontrate;
- b. diferencën e shumës finale të grantit, me të paraqitur raportin përfundimtar sipas dispozitave të nenit 12.

#### 8.2. Hapja e llogarive të dedikuara/të posaçme të Bashkisë

Pas nënshkrimit të kontratës së grantit, Përfituesi i kërkon Ministrisë së Financave që të hapë llogari të veçantë për fondin e grantit në Bankën e Shqipërisë dhe të autorizojë hapjen e një llogarie të dedikuar në një bankë të nivelit të dytë të licensuar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 35 datë 21 Shtator 2020. Bashkia i jep Entit të Deleguar kopje të këtyre kërkesave brenda 3 ditëve nga paraqitja zyrtare e kërkesave në Ministrinë e Financave.

#### 8.3. Procedura dhe afati i pagesës

- 8.3.1. Pas hapjes së llogarisë së veçantë nga Ministria e Financave në Bankën e Shqipërisë, Bashkia do të përgatisë kërkesën për para-financim duke përdorur modelin në Aneksin IV të kësaj Kontrate dhe do t'ia paraqesë Autoritetit Kontraktues përmes Entit të Deleguar. Pagesa fillestare e para-financimit bëhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditëve nga kërkesa e pagesës, tek llogaria bankare e dedikuar e Bashkisë në Bankën e Shqipërisë. Rrjedhimisht, Përfituesi aplikon në Ministrinë e Financave për të marrë fondet e para-financimit në llogarinë e dedikuar të nivelit të dytë sic përcaktohet në pikën 8.2.
- 8.3.2. Kërkesë për pagesë për pagimin e diferencës hartohet duke përdorur modelin në Aneksin IV të kësaj Kontrate. Pagesa e diferencës bëhet nga Autoriteti Kontraktues në llogarinë e dedikuar të Bashkisë në Bankën e Shqipërisë brenda 30 ditëve nga pranimi i kërkesës së pagesës paraqitur Autoritetit Kontraktues përmes Entit të Deleguar. Rrjedhimisht, Përfituesi aplikon në Ministrinë e Financave për të marrë fondet e diferencës në llogarinë e dedikuar të nivelit të dytë në bankën tregtare të zgjedhur prej tij.
- 8.3.3. Pagesa e diferencës është në varësi të disbursimit të bashkëfinancimit në përputhje me dispozitën pika 3.2 e kësaj Kontrate dhe paraqitjes në kohë të Raportit Narrativ dhe Financiar të Ndërmjetëm tek Autoriteti Kontraktues përmes Entit të Deleguar në përputhje me nenin 12 të kësaj Kontrate.
- 8.3.4. Kërkesa për pagesë konsiderohet e pranuar nëse nuk ka përgjigje me shkrim nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga dorëzimi i kërkesës.
- 8.3.5. Pagesa nuk nënkupton njohje të rregullshmërisë ose autenticitetit, plotësisë dhe korrektësisë të deklaratave dhe informacionit të dhënë.

#### 8.4. Valuta e Pagesës dhe Kursi i Këmbimit

- 8.4.1. Autoriteti Kontraktues bën pagesët në LEKË.

- 8.4.2. Kostot e bëra në valuta të tjera nga ajo që përdoret në llogarinë e Përfituesit për Projektin konvertohen sipas praktikave të zakonshme të mbajtjes së llogarive të Përfituesit, me kusht që të respektohen kërkesat bazë të mëposhtme:
- ato të jenë shkruar si një rregull kontabiliteti pra të jenë praktikë standarde e Përfituesit- në veçanti kursi i këmbimit për këmbimin e valutave të tjera në LEKË do të jetë kursi i këmbimit i Bankës së Shqipërisë në datën e pagesës.
  - të trajtojnë njësoj të gjitha llojet e transaksioneve dhe burimeve të financimit;
  - sistemi mund të tregohet dhe kursi i këmbimit të jetë lehtësisht i aksesueshëm për verifikime.

## 8.5. Pezullimi i pagesës

- 8.5.1. Pa cenuar nenin 18 për ndërprerjen, afati kohor për pagesën mund të pezullohet duke e njoftuar Përfituesin që:
- shumës së treguar në kërkesën e tij për pagesë nuk i ka ardhur afati, ose;
  - nuk janë dhënë dokumentet e duhura mbështetëse, ose;
  - nevojiten sqarime, modifikime ose informacion shtesë në raportet narrative ose financiare, ose;
  - ka dyshime për pranueshmërinë e shpenzimeve dhe është e nevojshme që të bëhen kontrolle shtesë, përfshirë kontrolle në terren që të sigurohet se shpenzimet janë të pranueshme, ose;
  - është e nevojshme të verifikohet nëse kanë ndodhur gabime thelbësore, parregullsi ose mashtrim në procedurën e shpalljes së kontratës fituese ose zbatimin e Projektit, ose;
  - është e nevojshme të verifikohet nëse Përfituesi ka shkelur ndonjë detyrim thelbësor sipas kësaj Kontrate;
- 8.5.2. Pezullimi i afateve kohore për pagimin fillon kur njoftimi i përcaktuar në pikën 8.5.1 i dërgohet Përfituesit sipas procedurës së njoftimit të rregulluar në nenin 20.12 më poshtë. Afati kohor fillon përsëri në datën e regjistrimit të kërkesës për pagesë të formuluar si duhet. Përfituesi jep çdo informacion të kërkuar, sqarim ose dokument brenda 15 ditëve të kërkesës. Nëse, pavarësisht informacionit, sqarimit ose dokumentit të dhënë nga Përfituesi, kërkesa për pagesë është akoma e papranueshme, ose nëse procedura e shpalljes së kontratës fituese ose zbatimit të grantit rezulton të ketë pasur gabime thelbësore, parregullsi, mashtrim, ose shkelje të detyrimeve, atëherë Autoriteti Kontraktues mund të refuzojë të vijojë më tej me pagesën dhe, në rastet e parashikuara në nenin 18 të kësaj Kontrate, mund të ndërpresë Kontratën në këto rrethana. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues mund të pezullojë pagesat si masë paraprake pa njoftim paraprak, përpara, ose në vend të, ndërprerjes së kësaj Kontrate.

## 8.6. Kamatë vonesa për pagesën

- 8.6.1. Nëse Autoriteti Kontraktues paguan Përfituesin pas afatit kohor, ai paguan kamat vonesë si më poshtë:
- me normën e ri-zbritur të përdorur nga banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, nëse pagesa është në valutë vendase;
  - më normën e përdorur nga Banka Qendrore Evropiane për transaksionet kryesore të rifinancimit në euro, nëse pagesat janë në euro;
  - në ditën e parë të muajit kur ka mbaruar afati, plus tre e gjysmë pikë përqindje. Interesi është i pagueshëm për kohën që ka kaluar ndërmjet mbarimit të afatit të pagesës dhe datës së debitimit të llogarisë së Autoritetit Kontraktues.
- 8.6.2. Përjashtimisht, kur interesi i llogarit sipas kësaj dispozite është më i ulët se ose i barabartë me 200 EUR, ai i paguhet Përfituesit vetëm pas kërkesës të paraqitur brenda dy muajve nga marrja e pagesës së vonuar.
- 8.6.3. Kamat vonesa nuk konsiderohet e ardhur për qëllime të nenit 10 të kësaj Kontrate.

## NENI 9

### Llogaritë dhe kontrollet teknike dhe financiare

#### Llogaritë

- 9.1. Përfituesi mban llogari të sakta dhe të rregullta të zbatimit të Projektit duke përdorur sistemin e duhur të mbajtjes së llogarive dhe librin e kontabilitetit të dyfishtë. Llogaritë:
- mund të jenë pjesë e integruar ose shtesë në sistemin e rregullt të Përfituesit;



- b) janë në përputhje me politikat e kontabilitetit dhe mbajtjes së llogarive dhe rregullat që zbatohen në Republikën e Shqipërisë;
  - c) mundësojnë gjurmimin, identifikimin dhe verifikimin e shpenzime që lidhen me Projektin.
- 9.2. Përfituesi sigurohet që raportet financiare të kërkuara sipas nenit 12 të kësaj Kontrate të jenë si duhet dhe lehtësisht në përputhje me sistemin e llogarive dhe kontabilitetit dhe me të dhënat e llogarive dhe të dhëna të tjera përkatëse. Për këtë qëllim, Përfituesi përgatit dhe mban rakordimin e duhura, planifikimin mbështetës, analizat dhe shpërndarjen për inspektim dhe verifikim.

### **Regjistrimi i të dhënave**

- 9.3. Përfituesi mban të gjitha të dhënat, llogaritë dhe dokumentet mbështetëse në lidhje me këtë kontratë për dhjetë vjet pas pagesës së diferencës dhe në çdo rast deri në mbarim të çdo verifikimi, apelimi, procesi gjyqësor ose ndjekje të pretendimit. Ato aksesohen lehtësisht dhe depozitohen për të lehtësuar shqyrtimin e tyre dhe Përfituesi do të njoftojë Autoritetin Kontraktues për vendndodhjen e tyre të saktë. I gjithë dokumentacioni mbështetës ose do të vihet në dispozicion në formën origjinale, përfshirë një formular elektronik, ose si kopje.
- 9.4. Përveç raporteve të përmendura në nenin 12 të kësaj Kontrate, dokumentet e përmendura në këtë nen përfshijnë:
- a. të dhëna llogarie (elektronike ose manuale) nga sistemi i kontabilitetit i Përfituesit, si libër llogarie i përgjithshëm, nën-libra llogarie, regjistra të aseteve të trupëzuara dhe informacion tjetër i rëndësishëm kontabiliteti;
  - b. vërtetim të procedurave të prokurimit, si dokumentacion tenderimi, oferta nga tenderues dhe raporte vlerësimi;
  - c. vërtetim të angazhimit si kontrata dhe formularë porosie;
  - d. vërtetim të ofrimit të shërbimeve si raporte të miratuara përfshirë dokumentacionin përkatës dhe materialet e marra, certifikatat, etj.;
  - e. vërtetim të marrjes së mallrave si fatura dorëzimi nga furnizuesit;
  - f. vërtetim të realizimit të punimeve, si certifikata nga Inxhinieri Mbikëqyrës, certifikata të testeve teknike (kolaudim), certifikata të pranimit të përkohshëm që lëshon Përfituesi;
  - g. vërtetim të blerjes së fatura;
  - h. vërtetime bankare mujore të llogarive të dedikuara në banka tregtare të vulosura rregullisht nga banka sic përcaktohet në pikën 8.2, njoftime borxhi, vërtetim të shlyerjeve nga kontraktori;

### **E drejta e aksesit**

- 9.5. Përfituesi lejon verifikime nga Autoriteti Kontraktues, Enti i Deleguar dhe çdo inspektor i jashtëm i autorizuar nga Donatori dhe/ose Autoriteti Kontraktues. Përfituesi duhet të marrë të gjitha hapat për të lehtësuar punën e tyre.
- 9.6. Përfituesi lejon që subjektet e përcaktuara në pikën 9.5, të:
- a. kenë akses në vendndodhje ku zbatohet Projekti;
  - b. ekzaminojë sistemet e tij të informacionit dhe llogarive, dokumentet dhe bazat e të dhënave në lidhje me menaxhimin teknik dhe financiar të Projektit;
  - c. marrë kopje të dokumenteve;
  - d. kryejë kontrole në terren si edhe të bëjë foto të vendndodhjeve dhe projektit;
  - e. kryejë verifikim të plotë në bazë të të gjitha dokumenteve të llogarive dhe çdo dokumenti tjetër të rëndësishëm për financimin e Projektit.
- 9.7. Aksesit që u jepet agjentëve të Autoritetit Kontraktues, të Entit të Deleguar dhe çdo inspektor të jashtëm të autorizuar nga Donatori dhe/ose Autoriteti Kontraktues që kryen verifikimet e parashikuara nga ky nen, si edhe neni 8.5 i kësaj Kontrate, do të bëhet në bazë të konfidencialitetit në lidhje me palët e treta, pa cenuar detyrimet e legjisllacionit shqiptar të zbatueshëm.
- 9.8. Gjetjet e verifikimit, sipas rastit, mund të çojnë në rikuperim të fondeve nga Autoriteti Kontraktues sipas procedurës të përcaktuar në nenin 11 të kësaj Kontrate.
- 9.9. Mospëmbushja e detyrimeve të përcaktuara në nenet 9.1 deri në 9/7 më sipër përbën një rast të shkeljes së detyrimit thelbësor sipas kësaj Kontrate. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues mund të pezullojë, në veçanti, Kontratën, pagesat ose afatin për pagesë, të ndërpresë Kontratën dhe/ose reduktojë grantin.

## NENI 10

### Shuma përfundimtare e Grantit

- 10.1. Granti mund të mos tejkalojë tavanin maksimal të përcaktuar në nenin 3.1 të kësaj Kontrate ose në lidhje me vlerën absolute, ose në lidhje me përqindjen e shprehur në të. Nëse kostot e lejueshme të Projektit në fund të projektit janë më pak se kostot e lejueshme të përlogaritura të përmendura në nenin 3.3, granti kufizohet në shumën e marrë duke aplikuar përqindjen e përcaktuar në nenin 3.1 për kostot e lejueshme të Projektit të miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 10.2. Gjithashtu dhe pa cenuar të drejtën e tij për të ndërprerë këtë Kontratë sipas nenit 18 të kësaj Kontrate, nëse Projekti zbatohet dobët ose pjesërisht, dhe prandaj jo në përputhje me Përshkrimin e Projektit në Aneksin II të kësaj kontrate, ose më vonë, Autoriteti Kontraktues, me një vendim të arsyetuar si duhet dhe pasi të lejojë Përfituesin që të paraqesë vëzhgimet e tij, ul shumën e grantit fillestar në përputhje me zbatimin aktual të Projektit dhe në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate. Kjo vlen edhe në lidhje me detyrimet për vizibilitet të përcaktuara në nenin 20.6.
- 10.3. Pa cenuar dispozitat e kësaj kontrate, shuma përkatëse e parafinancimit e bashkëfinancimit në përputhje me dispoziten pika 3.2 të kësaj Kontrate mund të përshtatet nga Përfituesi sipas “pari passu” me një përshtatje të grantit referuar pikës 3.1 sikurse sugjerohet nga paragrafi 10.1 dhe 10.2.

## NENI 11

### Rikuperimi

- 11.1. Nëse një shumë i është paguar Përfituesit gabimisht, ose nëse justifikohet rikuperimi sipas kushteve të kësaj Kontrate, Përfituesi merr përsipër t'i ripaguajë këtë shumë Autoritetit Kontraktues.
- 11.2. Në veçanti, pagesat e bëra nuk pengojnë mundësinë që Autoriteti Kontraktues të lëshojë një urdhër rekuperimi pas verifikimit të kërkesës për pagesë përfundimtare.
- 11.3. Përfituesi merr përsipër t'i ripaguajë Autoritetit Kontraktues çdo shumë të paguar që tejkalon shumën përfundimtare të grantit të përcaktuar dhe të vendosur sipas nenit 10, në llogarinë e dedikuar në Bankën e Shqipërisë, brenda 15 ditëve nga lëshimi i njoftimit të debisë por, në çdo rast, jo më vonë se data përmbylëse e zbatimit të projektit, cilido afat është më i hershëm, me kusht që shkresa me anë të të cilës Autoriteti Kontraktues kërkon shumën që detyrohet nga Përfituesi të jetë dërguar në përputhje me procedurën e njoftimit të përcaktuar në nenin 20.12 të kësaj Kontrate.
- 11.4. Nëse Përfituesi nuk ripaguan brenda afatit të vendosur nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontraktues mund të rrisë shumat që i detyrohen duke shtuar kamat vonesën e llogaritur nga dita e parë e muajit kur ka mbaruar afati, plus tre e gjysmë pikë përqindje. Kamat vonesa mbledhet gjatë kohës që kalon ndërmjet datës së afatit të pagesës të vendosur nga Autoriteti Kontraktues dhe datës së bërjes së pagesës. Çdo pagesë e pjeshme së pari mbulon kamat vonesën e përcaktuar.
- 11.5. Për qëllim të këtij neni, kamat vonesa llogaritet me normën e ri-zbritur të përdorur nga banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, nëse pagesa është në valutë vendase.
- 11.6. Shumat që duhet t'i ripaguhet Autoritetit Kontraktues mund të jenë kompensim për shumat e çdo lloji që i detyrohen Përfituesit, pas informimit të tij sipas rastit. Kjo nuk prek të drejtën e Palëve për të rënë dakord për pagesën me këste.
- 11.7. Ripagimi sipas paragrafit 11.4 ose kompensimi sipas paragrafit 11.6 përbëjnë shumën e pagesës së diferencës.
- 11.8. Pa cenuar prerogativat e Autoritetit Kontraktues, nëse është e nevojshme, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim si Donator, mund të vijojë vetë rikuperimin, me çdo mënyrë.

## NENI 12

### Detyrimi për të paraqitur Raporte Narrative dhe Financiare

- 12.1. Përfituesi i jep Autoritetit Kontraktues të gjithë informacionin e kërkuar për zbatimin e Projektit. Raportet përshkruajnë zbatimin e Projektit sipas veprimtarive të parashikuara, vështirësitë e hasura, masat e marra për të kapërcyer problemet, ndryshimet e mundshme të prezantuara si edhe shkallën e arritjes së rezultateve dhe plotësimin e outputeve të matura sipas treguesve përkatës. Raportet paraqiten në mënyrë të tillë që lejojnë monitorimin e objektivit(objektivave), mjetet e parashikuara ose të përdorura dhe detajet e buxhetit për Projektin. Nivelin e detajit në çdo raport duhet të përputhet me atë të Përshkrimit të Projektit dhe të Buxhetit për

Projektin të parashikuar për Propozimin e paraqitur. Përfituesi mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm dhe harton raporte të konsoliduara të ndërmjetme dhe përfundimtare. Këto raporte:

- a. mbulojnë Projektin në tërësi, pavarësisht se cila pjesë e tij financohet nga Autoriteti Kontraktues;
- b. përmbajnë pjesën narrative dhe financiare të hartuar duke përdorur modelet e dhëna në Aneksin V të kësaj kontrate;
- c. japin një paraqitje të plotë të të gjitha aspekteve të zbatimit të Projektit për periudhën e mbuluar;
- d. përmbajnë outputet aktuale të realizuara dhe rezultatet e arritura nga Projekti të matura duke përdorur treguesit përkatës; piketat dhe objektivat e miratuara dhe burimet e rëndësishme të verifikimit;
- e. hartohen në valutën dhe gjuhën e kësaj Kontrate;
- f. përmbajnë çdo raport të rëndësishëm, publik, njoftime për shtyp dhe përditësime në lidhje me Projektin.

Gjithashtu, raporti përfundimtar mbulon çdo periudhë që nuk e mbulon raporti i ndërmjetëm.

- 12.2. Raportet e ndërmjetme dhe financiare përmbajnë një shpërndarje të detajuar të shpenzimeve të kryera me listën e faturave dhe pagesat përkatëse të bëra ose në pritje. Këto raporte parashikojnë konvertime të valutës së shpenzimeve sipas rastit dhe kanë bashkëlidhur një kopje të secilës faturë të njehsuar me origjinalin nga Bashkia dhe me vulën e Bashkisë si edhe deklarata mujore të llogarisë bankare të dedikuara të hapur për projektin në një bankë tregtare, duke lejuar kështu rakordimin e secilit zë të shpenzimeve dhe pagesën e përfshirë në raportet financiare.
- 12.3. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë informacion shtesë në çdo kohë. Përfituesi e jep këtë informacion përmes Entit të Deleguar brenda 10 ditëve nga kërkesa në gjuhën e Kontratës.
- 12.4. Raportet e Ndërmjetëm – duhet të përgatiten çdo tre muaj nga fillimi i periudhës së zbatimit; Raporti Përfundimtar – duhet të paraqesë informacion të plotë për të gjithë periudhën e zbatimit. Nëse përfituesi nuk raporton ose nuk jep informacion shtesë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues ose Enti i Deleguar brenda afatit të caktuar pa një shpjegim të pranueshëm dhe me shkrim të arsyeve, Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë këtë Kontratë sipas nenit 18.2 (a) dhe (f).
- 12.5. Përfituesi paraqet Raportin e Ndërmjetëm tek Enti i Deleguar jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të periudhës së parë tremujore të periudhës së zbatimit, të përcaktuar në nenin 4.3 të kësaj Kontratë. Raporti përfundimtar paraqitet nga Përfituesi tek Enti i Deleguar jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të periudhës së zbatimit të përcaktuar në nenin 4.3 të kësaj Kontrate.

### NENI 13

#### Vlerësimi/Monitorimi i Projektit

- 13.1. Nëse Autoriteti Kontraktues kryen një mision vlerësimi ose monitorimi, Përfituesi merr përsipër që t'i japë atij dhe/ose personit të autorizuar prej tij dokumentet ose informacionin e nevojshëm për misionin e vlerësimit ose monitorimit.
- 13.2. Përfaqësuesit e Entit të Deleguar dhe Përfituesi ftohen që të marrin pjesë në misionin monitorues ose vlerësues në lidhje me realizimin e Projektit të kryer nga Autoriteti Kontraktues.
- 13.3. Nëse as Përfituesi as Autoriteti Kontraktues nuk kryen ose porosit një vlerësim në kuadër të Projektit, i jep tjetrit një kopje të raportit të vlerësimit.

### NENI 14

#### Modifikime të Kontratës

- 14.1. Çdo ndryshim dhe/ose shtyrje e kësaj Kontrate, si edhe anekset e saj, bëhen me shkrim. Kontrata mund të ndryshohet vetëm gjatë periudhës së ekzekutimit.
- 14.2. Ndryshimi mund të mos ketë qëllim ose efektin e bërjes së ndryshimeve në këtë Kontratë që do të vinin në pyetje vendimin e shpalljes së kontratës fituese ose do të ishin në kundërshtim me trajtimin e barabartë të aplikantëve. Megjithatë, ndryshimet që lejojnë rritje të outputit dhe/ose përmirësim të rezultateve të Kontratës lejohen me kusht që shumica e grantit të mos rritet. Granti maksimal i përmendur në nenin 3.1 të kësaj Kontrate nuk mund të rritet.
- 14.3. Nëse kërkohet ndryshim Përfituesi i paraqet Autoritetit Kontraktues përmes Entit të Deleguar një kërkesë të arsyetuar 30 ditë përpara datës të hyrjes në fuqi të ndryshimit, përveçse nëse ka rrethana të veçanta të

- mbështetura dhe të pranuar rregullisht nga Autoriteti Kontraktues sipas procedurës së njoftimit të përcaktuar në nenin 20.12.
- 14.4. Nëse ndryshimi në Buxhet ose Përshkrim të Projektit nuk ndikon në qëllimin bazë të Projektit dhe ndikimi financiar kufizohet në një transferim ndërmjet nën-zërave brenda të njëjtit zë kryesor buxhetor përfshirë anulimin ose prezantimin e një nën-zëri, ose një transferim ndërmjet zërave kryesore të buxhetit që përfshijnë një variacion prej 25% ose më pak të shumës të regjistruar në fillim (ose të modifikuar nga shtesa) në lidhje me secilin zë kryesor në fjalë për kosto të pranueshme, Enti i Deleguar mund të ndryshojë Buxhetin ose Përshkrimin e Projektit dhe të informojë me shkrim Autoritetin Kontraktues përmes Entit të Deleguar përkatësisht, brenda 3 ditëve nga transferimi ndërmjet nën-zërave brenda të njëjtit zë kryesor të buxhetit. Kjo metodë mund të mos përdoret për të ndryshuar zërat për shpenzime vizibiliteti.
- 14.5. Përfituesi mund t'i njoftojë ndryshimin e adresës ose llogarisë bankare Autoritetit Kontraktues përmes Entit të Deleguar. Megjithatë, në rrethanë të mbështetura rregullisht, Autoriteti Kontraktues mund të kundërshtojë ndryshimet.

#### **NENI 15 Zbatimi**

- 15.1. Nëse Përfituesi duhet të lidhë kontrata zbatimi me kontraktorët për të zbatuar Projektin, ai do të veprojë sipas legjislacionit shqiptar për prokurimin publik në fuqi.
- 15.2. Pa rënë ndesh me dhe përveç përcaktimeve të pikës 15.1, në rastin e kontratave për punime, Përfituesi do i kërkojë Kontraktorëve të zgjedhur, jo më vonë se data e vendosur për fillimin e punimeve, një letër garanci që do të zëvendësojë mbajtjen e parave nga pagesat e ndërmjetme me anë të garancisë për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit gjatë periudhës së përgjegjësisë për defektin.
- 15.3. Garancia e përcaktuar në pikën 15.2, do të jetë në formatin e parashikuar në kontratë sipas Aneksit VI dhe mund të jepet në formën e një garancie bankare, një drafti bankar, një cek, një garancie sigurimi të dhënë nga një kompani sigurimi, një letër kredie e parevokueshme, ose një depozite në para tek Përfituesi. Nëse garancia e performancës duhet të jepet në formën e një garancie bankare, drafti bankar, ceku ose garancia e sigurimit, ajo lëshohet nga një bankë ose kompani sigurimi të miratuar nga Përfituesi. Garancia emërtohet në llojet dhe raportet e valutave me të cilat paguhet kontrata origjinale. Asnjë pagesë nuk bëhet në favor të Kontraktorit përpara dhënies së garancisë. Garancia jepet brenda 60 ditëve nga fundi i periudhës së përgjegjësisë për defektin për shumën e plotë përveç shumave që janë objekt i marrëveshjeve miqësore, arbitrazhit ose procesit gjyqësor.
- 15.4. Përfituesi në raportet e tij për Autoritetin Kontraktues, përmes Entit të Deleguar jep informacion të plotë për shpalljen e fituesit dhe zbatimin e kontratave fituese sipas nenit 15.1, në përputhje me kërkesat e raportimit të parashikuara në nenin 12.

#### **NENI 16**

##### **Shtyrja e periudhës së zbatimit të projektit**

- 16.1. Përfituesi përmes Entit të Deleguar informon Autoritetin Kontraktues pa vonesë për çdo rrethanë që mund të pengojë ose të vonojë zbatimin e Projektit. Përfituesi mund të kërkojë përmes Entit të Deleguar një shtyrje të periudhës së zbatimit të Projektit siç parashikohet në nenin 4.2 të kësaj Kontrate në përputhje me nenin 14. Kërkesa shoqërohet me të gjitha provat mbështetëse të nevojshme për vlerësimin e saj.
- 16.2. Në asnjë rast, shtyrja e periudhës së zbatimit nuk mund të jetë më vonë se \_\_\_\_\_.

#### **NENI 17**

##### **Pezullimi**

- 17.1. Përfituesi mund të pezullojë zbatimin e Projektit, ose çdo pjesë të tij, nëse rrethanë të jashtëzakonshme, sidomos forca madhore, e bëjnë zbatimin tepër të vështirë ose të rrezikshëm. Përfituesi informon Autoritetin Kontraktues përmes Entit të Deleguar pa vonesë, duke shprehur natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të pezullimit.

- 17.2. Përfituesi ose Autoriteti Kontraktues më pas mund të ndërpresin këtë Kontratë në përputhje me nenin 18.1. Nëse Kontrata nuk ndërpritet, Përfituesi bën përpjekje për të minimizuar kohën e pezullimit të saj dhe çdo dëm të mundshëm dhe vijon me zbatimin sapo ta lejojnë rrethanat dhe pasi të ketë marrë nga Enti i Deleguar miratimin e Autoritetit Kontraktues.
- 17.3. Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë Përfituesit përmes Entit të Deleguar që të pezullojë zbatimin e Projektit, ose një pjesë të tij, nëse rrethanat të jashtëzakonshme, sidomos forca madhore, e bëjnë zbatimin tepër të vështirë ose të rrezikshëm. Për këtë qëllim, Autoriteti Kontraktues njofton Përfituesin përmes Entit të Deleguar duke shprehur natyrën dhe kohëzgjatjen e mundshme të pezullimit.
- 17.4. Autoriteti Kontraktues gjithashtu mund të pezullojë këtë Kontratë ose pjesëmarrjen e Përfituesit në këtë Kontratë nëse Autoriteti Kontraktues ka të dhëna që, ose nëse, për arsye objektive dhe të mirë justifikuar, Autoriteti Kontraktues e gjykon të nevojshëm verifikimin nëse duke prezumuar që:
- procedura e shpalljes së kontratës fituese të grantit ose zbatimit të Projektit ka qenë subjekt i gabimeve thelbësore, parregullsi ose mashtrim;
  - Përfituesi ka shkelur çdo detyrim thelbësor sipas kësaj Kontrate.
- 17.5. Përfituesi jep çdo informacion të kërkuar, sqarim ose dokument brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesave dërguar Autoritetit Kontraktues dhe/ose Entit të Deleguar. Nëse, pavarësisht informacionit, sqarimit ose dokumenteve të dhëna nga Përfituesi, procedura e shpalljes së kontratës fituese ose realizimi i grantit rezultojnë të kenë gabime thelbësore, parregullsi, mashtrim ose shkelje të detyrimeve, atëherë, Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë këtë Kontratë sipas nenit 18(2) h.
- 17.6. Përfituesi nuk konsiderohet se ka shkelur detyrimet e tij kontraktuale nëse pengohet për përmbushjen e tyre nga rrethanat e forcës madhore.
- 17.7. Në rast pezullimi sipas neneve 17.1, 17.3 dhe 17.5, periudha e zbatimit të Projektit shtyhet me një periudhë ekuivalente me kohëzgjatjen e pezullimit me kusht që të respektohen dispozitat e nenit 16.2, pa cenuar ndonjë ndryshim në Kontratë që mund të jetë i nevojshëm për të përshtatur Projektin me kushtet e reja të zbatimit.

## NENI 18

### Ndërprerja e Kontratës

- 18.1. Në rastet e parashikuara në nenin 17.1 dhe 17.3 nëse Përfituesi ose Autoriteti kontraktues beson që kjo Kontratë nuk mund të ekzekutohet më në mënyrë të efektshme ose siç duhet, ata konsultojnë rregullisht njëri-tjetrin. Nëse nuk arrihet marrëveshje për një zgjidhje, Përfituesi ose Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë këtë Kontratë duke dhënë dy muaj njoftim me shkrim, pa ju kërkuar pagesa e dëmshpërblimit.
- 18.2. Pa cenuar nenin 18.1, në rrethanat e mëposhtme Autoriteti Kontraktues, pas konsultimit me Entin e Deleguar dhe Përfituesin, mund të ndërpresë këtë Kontratë pa ndonjë dëmshpërblim nga ana e tij kur:
- Përfituesi pa arsye, nuk përmbush detyrimin thelbësor të vendosur ndaj tij nga kjo Kontratë dhe, pasi njoftohet me shkresë për përmbushjen e këtyre detyrimeve, akoma nuk e bën këtë ose nuk jep një shpjegim të pranueshëm brenda 30 ditëve nga marrja e shkresës;
  - Përfituesi, ose çdo subjekt ose person i lidhur me të, është gjetur fajtor për një shkelje në lidhje me sjelljen e tyre profesionale të provuar me çdo mjet;
  - me një vendim përfundimtar ose vendim administrativ përfundimtar ose me një vërtetim që ka Autoriteti Kontraktues është vendosur që Përfituesi ka qenë fajtor për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, pastrim parash ose financim të terrorizmit, vepra penale të lidhura me terrorizmin, punën e fëmijëve ose forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore ose ka kryer një parregullsi;
  - ndryshimi në situatën ligjore, financiare, teknike, organizative ose të pronësisë të Përfituesit ose ndërprerja e pjesëmarrjes së Përfituesit thelbësisht ndikon zbatimin e kësaj kontrate ose vë në pikëpyetje vendimin që shpall kontratën fituese të grantit;
  - Përfituesi ose çdo person që lidhet me të, është fajtor për keqpërfaqësim në dhënien e informacionit të kërkuar në procedura të shpalljes së fituesit ose në zbatimin e Projektit ose nuk jep- ose nuk jep brenda afatit të vendosur sipas kësaj Kontrate- informacion në lidhje me Projektin të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues;
  - Përfituesi nuk ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose pagesën e taksave në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë;

- g. Autoriteti Kontraktues ka të dhëna që Përfituesi, ose çdo subjekt apo person që lidhet me të, ka kryer gabime thelbësore, parregullsi ose mashtrim në procedurën e shpalljes së fituesit ose në zbatimin e Projektit;
  - h. Përfituesi është subjekt i një gjobe administrative të përmendur në nenin 19.1;
  - i. Autoriteti Kontraktues ka të dhëna që Përfituesi i nënshtrohet një konflikti interesi;
  - j. Autoriteti Kontraktues ka të dhëna që Përfituesi ka bërë gabime sistemike ose të përsëritura ose parregullsi, mashtrime ose shkelje të rëndë të detyrimeve në grante të tjera të financuara nga Autoriteti Kontraktues dhe që i janë dhënë atij Përfituesi specifik në kushte të njëjta, me kusht që këto gabime, parregullsi, mashtrime ose shkelje të rënda të detyrimeve të kenë pasur ndikim material tek ky grant.
- 18.3. Rastet e ndërprerjes sipas pikave (b), (c), (d), (h), (j) dhe (k) mund t'i referohen edhe personave që janë anëtarë të organit administrativ, të menaxhimit ose mbikëqyrës të Përfituesit dhe/ose personave që kanë autorizim përfaqësimi, vendimi ose kontrolli në lidhje me Përfituesin.
- 18.4. Në rastet e përmendura në pikat (c), (f), (h) dhe (k) më sipër, çdo person i lidhur me të do të thotë çdo person fizik me autorizim përfaqësimi, vendimi ose kontrolli në lidhje me Përfituesin. Çdo subjekt i lidhur do të thotë çdo subjekt të cilit i janë deleguar funksione sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 18.5. Detyrimet e pagesës të Autoritetit Kontraktues sipas kësaj Kontrate përfundojnë 6 muaj pas periudhës së zbatimit të përcaktuar në nenin 4.2 përveçse nëse kjo Kontratë ndërpritet sipas përcaktimeve të këtij neni. Autoriteti Kontraktues e shtyn këtë datë të fundit, me qëllim që të përmbushë detyrimet e pagesës, në të gjitha rastet kur Përfituesi ka paraqitur një kërkesë për pagesë në përputhje me dispozitat kontraktuale, ose në rast mosmarrëveshjeje, deri në përfundim të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes të parashikuar në nenin 20.7. Autoriteti Kontraktues njofton Përfituesin për çdo shtyrje të datës së fundit.
- 18.6. Kjo Kontratë do të përfundojë në mënyrë automatike nëse nuk ka çuar në ndonjë pagesë nga Autoriteti Kontraktues brenda 6 muajve të nënshkrimit.
- 18.7. Pas ndërprerjes së kësaj Kontrate, Përfituesi merr hapat e menjëhershme që të sjellë drejt fundit Projektin në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe të redukojë shpenzimet e mëtejshme në minimum.
- 18.8. Pa cenuar nenin 7 të kësaj Kontrate, Përfituesi ka të drejtë për pagesë vetëm për pjesën e Projektit të kryer, duke përjashtuar kostot në lidhje me angazhimet aktuale që duhet të ekzekutohen pas ndërprerjes. Për këtë qëllim, Përfituesi paraqet një kërkesë për pagesë tek Autoriteti Kontraktues brenda afatit kohor të caktuar nga neni 12.5 duke filluar nga data e ndërprerjes.
- 18.9. Në rast të ndërprerjes sipas nenit 18.1, Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakord që të rimbursojë shpenzimet e mbetura të pashmangshme të kryera gjatë periudhës së njoftimit, nëse, është ekzekutuar si duhet paragrafi i parë i nenit 18.8.
- 18.10. Në rastet e ndërprerjes të parashikuar në nenin 18.2 a), c), d), f), h) dhe k) Autoriteti kontraktues, pas konsultimit të Përfituesit dhe në varësi të rëndesës së mospërmbushjeve, mund të kërkojë ripagimin e plotë ose të pjesshëm të shumave të paguara për Projektin në mënyrë jo të rregullt.

## NENI 19

### Sanksione administrative

- 19.1. Pa cenuar zbatimin e zgjidhjeve të tjera të përcaktuara në Kontratë, masa e përjashtimit nga të gjitha kontratat dhe grantet e financuara nga Autoriteti kontraktues mund të merret, pas një procedure me palë kundërshtare, ndaj Përfituesit që, në veçanti:
- a. është fajtor për shkelje të rëndë profesionale, ka kryer parregullsi ose ndaj të cilit janë gjetur shkelje të rënda të detyrimeve të tij kontraktuale. Kohëzgjatja e përjashtimit nuk tejkalon kohëzgjatjen prej tre vjetësh të vendosur me vendim përfundimtar ose vendim administrativ përfundimtar, ose në mungesë të tij;
  - b. është fajtor për mashtrim, korrupsion, pjesëmarrje në një organizatë kriminale, pastrim të parave, vepra terrorizmi, punë të fëmijëve ose trafikim të qenieve njerëzore. Kohëzgjatja e përjashtimit nuk tejkalon kohëzgjatjen prej pesë vjetësh të vendosur me vendim përfundimtar ose vendim administrativ përfundimtar, ose në mungesë të tyre;
- 19.2. Në situatat e përmendura në nenin 19.1 si shtesë ose alternativë sanksionit të përjashtimit, Përfituesi mund t'i nënshtrohet edhe gjobave.

- 19.3. Kur Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të vendosë gjobë, mund të zbresë këto gjoba nga çdo shumë që i detyrohet Përfituesit ose përdorë garancinë e duhur.
- 19.4. Sanksionet administrative të mësipërme gjithashtu mund të vendosen ndaj personave që janë anëtarë në organin administrativ, të menaxhimit ose mbikëqyrjes të Përfituesit, ndaj personave që kanë të drejtë përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli në lidhje me përfituesin.

## NENI 20

### Dispozita përfundimtare

#### 20.1. Përgjegjësia

**20.1.1.** Autoriteti Kontraktues, Enti i Deleguar, ose Donatori, në asnjë rrethanë ose për asnjë arsye cilado qoftë ajo nuk mund të jetë përgjegjës për dëm ose dëmtim të pësuar nga stafi ose ndaj pronës së Përfituesit gjatë zbatimit të Projektit ose si pasojë e Projektit. Prandaj, Autoriteti Kontraktues nuk mund të pranojë kërkesa për kompensim ose rritje në pagesë në lidhje me këtë dëm ose dëmtim.

**20.1.2.** Përfituesi mban i vetëm përgjegjësi ndaj palëve të treta, përfshirë përgjegjësinë për dëm ose dëmtim të çdo lloji të pësuar prej tij gjatë zbatimit të Projektit ose si pasojë e Projektit. Përfituesi e çliron Autoritetin kontraktues nga çdo përgjegjësi që lind nga ndonjë pretendim ose padi e ngritur si pasojë e shkeljes së rregullave ose rregulloreve nga Përfituesi ose punonjësi apo individë të Përfituesit për të cilët ata punonjës janë përgjegjës, ose si pasojë e shkeljes së të drejtave të palës së tretë. Për qëllim të këtij neni, punonjësit e Përfituesit konsiderohen palë të treta.

#### 20.2. Konflikti i interesit dhe sjellja e mirë

**20.2.1.** Përfituesi merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ose përfunduar çdo situatë që mund të kompromentojë ekzekutimin e paanshëm dhe objektiv të kësaj Kontrate. Ky konflikt interesi mund të lindë në veçanti si pasojë e interesit ekonomik, politik ose etnik, lidhjeve familjare ose emocionale, ose çdo lidhje tjetër e rëndësishme ose e interesit të përbashkët.

**20.2.2.** Çdo konflikt interesi që mund të lindë gjatë ekzekutimit të kësaj Kontrate duhet t'i njoftohet me shkrim Autoritetit Kontraktues dhe Entit të Deleguar pa vonesë. Në rast të këtij konflikti, Përfituesi merr menjëherë masat e duhura për ta zgjidhur atë.

**20.2.3.** Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën që të verifikojë që masat e marra janë të duhura dhe mund të kërkojë marrjen e masave shtesë nëse është nevoja.

**20.2.4.** Përfituesi sigurohet që stafi i tij, si edhe niveli drejtues, të mos jetë në situatë që mund të çojë në një konflikt interesi. Pa cenuar detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, përfituesi zëvendëson menjëherë dhe pa kompensim nga Autoriteti Kontraktues, çdo anëtar të stafit të tij në këtë situatë.

**20.2.5.** Përfituesi respekton të drejtat e njeriut dhe legjislacionin e zbatueshëm mjedisor përfshirë marrëveshjet mjedisore shumëpalëshe si edhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht të punës thelbësore.

#### 20.3. Konfidencialiteti

**20.3.1.** Sipas nenit 9 të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues dhe Përfituesi marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni, pavarësisht formës së tij, të shprehur me shkrim ose me gojë në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate dhe të identifikuar me shkrim si konfidenciale deri të paktën 5 vjet pas pagesës së diferencës.

**20.3.2.** Nëse nuk e kërkon legjislacioni shqiptar në fuqi, Përfituesi nuk e përdor informacionin konfidencial për ndonjë qëllim të ndryshëm nga përmbushja e detyrimeve sipas kësaj Kontrate nëse nuk bihet dakord ndryshe me Autoritetin Kontraktues.

#### 20.4. Pronësia/Përdorimi i rezultateve dhe asetëve

**20.4.1.** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Thirrjen për Propozime, pronësia dhe titulli dhe të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale ndaj rezultateve të projektit, raportet dhe dokumentacion tjetër në lidhje me të do t'i besohet Përfituesit.

**20.4.2.** Pa cenuar nenin 20.6 Përfituesi i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën të përdorë lirisht dhe siç e shihet në përshtatshme, dhe në veçanti, të ruajë, ndryshojë, përkthejë, shfaqë, riprodhojë me anë të çdo procedure teknike, të publikojë ose të komunikojë me anë të çdo mjeti të gjitha dokumentet që rrjedhin nga Projekti në cilëndo formë, nëse kjo nuk cenon të drejtat ekzistuese të pronësisë industriale dhe intelektuale.

**20.4.3.** Përfituesi sigurohet që ka të gjitha të drejtat të përdorë çdo të drejtë pronësie intelektuale që ka ekzistuar më përpara të nevojshme për zbatimin e kësaj Kontrate.

## 20.5. Mbrojtja e të dhënave

**20.5.1.** Çdo e dhënë personale do të përpunohet vetëm për qëllimet e ekzekutimit, menaxhimit dhe monitorimit të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues dhe Enti i Deleguar, dhe mund t'i përcillet edhe organeve të ngarkuara me detyrat e monitorimit ose inspektimit sipas ligjeve përkatëse të Republikës së Shqipërisë. Përfituesit do të kenë të drejtën e aksesit në të dhënat e tyre personale dhe të drejtën për të korrigjuar këto të dhëna. Nëse Përfituesi ka ndonjë kërkesë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, ata do ia drejtojnë ato kërkesa Autoritetit Kontraktues. Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, Përfituesi do të ketë të drejtën e ankimit në çdo kohë përpara Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**20.5.2.** Përfituesi kufizon aksesin dhe përdorimin e të dhënave personale tek ajo që është tepër e nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe monitorimin e kësaj Kontrate dhe miraton të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative të sigurisë të nevojshme për të ruajtur konfidencialitetin më të madh dhe për të kufizuar aksesin në të dhëna.

## 20.6. Vizibiliteti dhe Komunikimi Publik

**20.6.1.** Përfituesi merr të gjitha masat e nevojshme për të publikuar faktin që Donatori ka financuar ose bashkë-financuar Projektin. Në veçanti, Përfituesi e përmend Projektin dhe kontributin financiar të Donatorit në informacionin dhënë marrësve fundorë të Projektit, në raportet e tij të brendshme dhe vjetore, dhe në marrëdhënien me median. Ai tregon logon e Donatorit sipas rastit.

**20.6.2.** Çdo njoftim ose publikim nga Përfituesi në lidhje me Projektin, si edhe ato të dhëna në konferenca ose seminare, specifikojnë që Projektin është financuar nga Donatori.

**20.6.3.** Vizibiliteti dhe komunikimi publik i Projektit ndjek rregullat e përcaktuara sipas Aneksit VII të kësaj Kontrate.

**20.6.4.** Çdo publikim nga Përfituesi/t, në çfarëdo formë dhe me çdo mjet, si edhe internet, përfshin deklaratën e mëposhtme: *Publikimet e PZHRSH janë kontribute në debatin për politikën e zhvillimit rajonal dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Donatorëve*”.

**20.6.5.** Përfituesi autorizon Donatorin, Autoritetin Kontraktues dhe Entin e Deleguar që të publikojë emrin dhe adresën e tij, shtetësinë, qëllimin e grantit, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen si edhe shumën maksimale të grantit dhe nivelin e financimit të kostove të Projektit.

## 20.7. Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

**20.7.1.** Kjo Kontratë rregullohet me ligjin e Republikës së Shqipërisë.

**20.7.2.** Palët në këtë Kontratë bëjnë gjithçka që është e mundur për të zgjidhur në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje që lind mes tyre gjatë zbatimit të kësaj Kontrate. Për këtë qëllim, ato komunikojnë pozicionin e tyre dhe çdo zgjidhje që e konsiderojnë të mundshme me shkrim dhe takohen me kërkesë të njërit apo tjetrit. Përfituesi dhe Autoriteti Kontraktues i përgjigjen një kërkesë të dërguar për zgjidhjen miqësore të mosmarrëveshjes brenda 20 ditëve. Pas mbarimit të kësaj periudhe ose nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore nuk ka prodhuar një marrëveshje brenda 60 ditëve të kërkesës së parë, Përfituesi ose Autoriteti Kontraktues mund të njoftojnë palën tjetër që ai e konsideron procedurën të dështuar.

**20.7.3.** Në rast dështimi të procedurave të mësipërme, secila palë e kësaj Kontrate mund të paraqesë mosmarrëveshjen në gjykatën e shkallës së parë të Tiranës, Republika e Shqipërisë.

## 20.8. Heqja dorë

Mosushtimi ose vonesa në ushtrim e një të drejte ose zgjidhjeje të parashikuar nga kjo Kontratë ose nga ligji nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose zgjidhja ose heqje dorë nga të drejta ose zgjidhje të tjera. Asnjë ushtrim i vetëm apo i pjesshëm i një të drejte ose zgjidhjeje të parashikuar nga kjo Kontratë ose nga ky ligj nuk pengon ushtrimin e mëtejshëm të të drejtës ose zgjidhjes ose ushtrimin e të drejtës ose zgjidhjes tjetër.

## 20.9. Pasardhësit dhe nënkontraktimi

Kjo Kontratë është e detyrueshme për palët dhe pasardhësit e tyre përkatës dhe nënkontraktuesit e lejuar. Asnjë palë nuk nënkontraktin apo transferon të gjithave ose një pjesë të të drejtave ose detyrimeve sipas kësaj Kontrate, vullnetarisht ose jo, me anë të zbatimit të ligjit apo ndryshe, pa pëlqimin me shkrim të Palës tjetër.



#### 20.10. Vlefshmëria

Nëse ndonjë dispozitë ose detyrim sipas këtij Kreu është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i paekzekutueshëm në juridiksionin shqiptar ose në çdo juridiksion tjetër të cilit i nënshtrohet kjo kontratë, vlefshmëria, ligjshmëria dhe ekzekutueshmëria e dispozitave që mbeten ose detyrimeve ose të kësaj dispozitë ose detyrimi në juridiksion, nuk do të ndikohet ose pengohet në asnjë mënyrë prej tyre. Palët bien dakord të përpiqen të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme ose të paekzekutueshme me dispozitë tjetër që, në masën më të madhe të mundshme, arrin qëllimet e dispozitave të pavlefshme ose të paekzekutueshme.

#### 20.11. Kopjet

Kjo Kontratë mund të ekzekutohet në një ose më shumë kopje, ku secila prej tyre e ekzekutuar dhe e dorëzuar konsiderohet origjinale, por të gjitha këto kopjet së bashku konsiderohen një instrument i vetëm dhe i njëjtë; faqet e nënshkrimit mund të hiqen nga kopje të veçanta të shumëfishta dhe t'i bashkëlidhen një kopjeje të vetme me qëllim që të gjitha faqet me firma të lidhen fizikisht me të njëjtin dokument.

#### 20.12. Procedura e njoftimit

**20.12.1.** Çdo njoftim, lajmërim, kërkesë, ose komunikim tjetër për çdo qëllim sipas kësaj Kontrate bëhet me shkrim dhe drejtohet në adresën zyrtare postare të Palëve dhe Entit të Deleguar si më poshtë:

##### **Nëse i drejtohet Autoritetit Kontraktues:**

Personi i kontaktit: \_\_\_\_\_

Adresa postare: \_\_\_\_\_ Tiranë, Shqipëri.

##### **Nëse i drejtohet Përfituesit:**

Personi i kontaktit: \_\_\_\_\_

Adresa postare: \_\_\_\_\_ Tiranë, Shqipëri.

##### **Nëse i drejtohet Entit të Deleguar:**

Personi i kontaktit: \_\_\_\_\_

Adresa postare: \_\_\_\_\_ Tiranë, Shqipëri.

**20.12.2.** Secila nga adresat më sipër mund të ndryshohet nga Palët përkatëse dhe këto ndryshime duhet t'i njoftohen me shkrim Palës tjetër. Adresa zyrtare e çdo pale për qëllim të kësaj Kontrate duhet të jetë adresa e fundit që u njoftohet atyre.

**20.12.3.** Njoftimet me postë dërgohen me rekomandë. Njoftimi konsiderohet i marrë kur lëshohet konfirmimi.

#### 20.13. Llogaritja e afatit kohor

Të gjitha referencat për ditët janë ditë kalendarike, përveçse nëse specifikohet ndryshe.

#### NENI 20.14. Gjuha

Gjuha e Kontratës është gjuha shqipe me përkthimin zyrtar në gjuhën angleze.

#### 20.15. Anekse

**20.15.1.** Dokumentet e mëposhtme i bashkëlidhen kësaj Kontrate dhe janë pjesë e pandarë e saj.

- ✓ Aneksi I: Thirrja për Aplikime publikuar në 20 Korrik 2020
- ✓ Aneksi II: Përshkrimi i Projektit
- ✓ Aneksi III: Buxheti i Projektit
- ✓ Aneksi IV: Kërkesa për pagesë
- ✓ Aneksi V: Model Raporti Narrativ dhe Financiar



- ✓ Aneksi VI: Model Letër Garancie
- ✓ Aneksi VII: Vizibiliteti dhe rregullat e komunikimit publik

**20.15.2.** Në rast konkurrence mes dispozitave të kësaj Kontrate dhe çdo Aneksi të saj, Kontrata do të ketë përparësi.

**Për Përfituesin**

Emri  
Titulli  
Nënshkrimi  
Datë

**Për Autoritetin kontraktues**

Emri  
Titulli  
Nënshkrimi  
Datë